



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 6077 Prot

Shkodër, më 19.04.2022

URDHËR
Nr. 306, datë 19.04.2022

“PËR
OFRIMIN E SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE NË DISA PREJ NJËSIVE
ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SHKODËR”

Mbështetur në pikën 2 të nenit 7, pikën 2 të nenit 8, germën a) dhe f) të nenit 66 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin Nr.115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr.196, datë 01.04.2022 “Për delegim kompetence”, vendimit nr.207, datë 13.04.2022, vendimit nr.208, datë 13.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër “Për lirim nga detyra”,

URDHËROJ:

- Ofrimin e shërbimeve (lëshimin e vërtetimeve) nga ana e Njesisë Administrative Dajç dhe Postribë të Bashkisë Shkodër.
- Plotësimimi i tyre do të bëhet sipas tabelës në vijim:

Nr.	Lënda	Personi përgjegjës për plotësim	Nënshkrimi
1.	Autorizim për tërheqje pensioni	Kryetari i fshatit	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
2.	Vërtetim banimi	Zyra e Gjendjes Civile	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
3.	Vërtetim identiteti	Zyra e Gjendjes Civile / Kryetari i fshatit	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
4.	Vërtetim korrigjim emri dhe/ose mbiemri	Zyra e Gjendjes Civile / Kryetari i fshatit	Zv.Kryetari Tonin Dedaj

5.	Vërtetim lidhje me të burgosur	Zyra e Gjendjes Civile / Kryetari i fshatit	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
6.	Vërtetim shpenzime varrimi	Kryetari i fshatit	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
7.	Vërtetim pagese paaftësie	Specialist i Drejtorisë së NE pranë njësisë	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
8.	Vërtetim pension invaliditeti	Specialist i Drejtorisë së NE pranë njësisë	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
9.	Vërtetim likujdim taksa & tarifa vendore	Specialist i Drejtorisë së të Ardhurave pranë njësisë	Zv.Kryetari Tonin Dedaj
10.	Vërtetim përfitimi te tokës bujqësore sipas ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar	Specialist i Drejtorisë së Bujqësisë pranë njësisë	Zv.Kryetari Tonin Dedaj

- Për plotësimin e vërtetimeve të mësipërme kërkesat do të regjistrohen në zyrat me një ndalesë (Z1N) të njësive administrative përkatëse. Kërkesat do të pranohen gjatë gjithë ditës së punës.
- Vërtetimet hartohen në tre kopje, dy prej të cilave do të jenë për përdorim të brendshëm dhe duhet të jenë të nënshkruara nga nëpunësit e ngarkuar në pikën 2 të këtij vendimi, ndërsa kopja e tretë do t’i jepet kërkuarit dhe të jetë e nënshkruar vetëm nga Zv.Kryetari.
- Sa i përket hartimit të shkresave apo korrespondencës me/për të tretët çdo shkresë do të përcillet nga specialist i Z1N të njësive përkatëse, për trajtim pranë administratës së Bashkisë Shkodër.
- Ky urdhër do të jetë i vlefshëm deri në emërimin e Administratorëve të Nj.A Dajç dhe Postribë nga Kryetari i Bashkisë Shkodër.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Bardh SPAHIA

